



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Kuvendi i Komunës**



Nr. 02-020-57196 dt. 22.11 2023

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 4,7,8,9 të udhëzimit administrativ Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 22.11.2023, miratoi këtë:

Vendim

Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të kufizuara

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës miratoi listën e panelit përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve

Neni 2

Kuvendi i Komunës themeloi panelin përzgjedhës i cili duhet të këtë në përbërje tre anëtarë të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

Lista e anëtarëve të panelit përzgjedhës janë:

1. Zahrie Podrimqaku-Subashi (Anëtare nga Ekzekutivi)
2. Shqipe Hoxha (Anëtare nga Shoqëria Civile)
3. Malsore Cakiqi (Anëtare nga Kuvendi)
4. Mehedin Salihu (Anëtarë nga Kuvendi)
5. Filloreta Bujupi (Anëtare nga Kuvendi)

Neni 3

Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

- Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit ;
 - Drejtorisë Përkatëse;
 - Zyrës së Kuvendit;
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim

Komuna Drenasit Respektivisht Kryetari i Komunës duke pasur parasysh që komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, sipas vendimit nr. 12.020-56967 dt. 27.09.2019 të Kuvendit të Komunës të Kuvendit të komunës i ka përfunduar mandati në bazë të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

Duke u Bazuar në nenin 8 pika 3 në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna paneli përzgjedhës duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve, ku 3 anëtar nga Kuvendi Komunal, 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Paneli përzgjedhës zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ duhet ta bëjë në përputhje të plot me udhëzimin administrativ për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.